

Shenjtori i ditës



E premte, 11 shtator 2020 – Shenjtori i ditës.

DITË KRESHME

Oshënare Theodhora në Aleksandri. Oshënar Efrosin Kuzhinieri. Dëshmore Evanthia.
– Oshënare Theodhora në Aleksandri –

Zoti ka thënë se Mbretëria e Qiejve i ngjan dhjetë virgjërëshave. Kjo është vërtetuar në praktikë nga dhjetë gratë e shenjta të kremtuara në Kishë, të cilat jetuan të veshura me rroba burrash dhe praktikuan asketizmin në manastiret e burrave. Shën Theodhora, e cila jetoi në Aleksandri në kohën e perandorit Zenon (474-491), është njëra nga këto gra të shenjta. Ajo ishte martuar me një njeri të devotshëm e të respektuar që quhej Pafnut; por një ditë, e shtyrë nga djalli, ajo shkeli kurorën. Shumë shpejt, pas këtij mëkati, ndërgjegjja e saj u rëndua aq shumë, saqë nuk guxoi më të shkonte në shtëpi, por ndjeu një dëshirë të fortë për pendim. Kështu, e veshur si burrë dhe duke e quajtur veten Theodhor, kërkoi të pranohej si rishtare në një manastir që ndodhej aty pranë. Igumeni, duke menduar

se ishte një eunuk dhe se ishte fort e vendosur të ecte në rrugën e pendimit, e pranoi menjëherë në manastir dhe e veshi me rrobën engjëlllore.

Për dy vjet me radhë, shën Theodhora tregoi një zell të zjarrtë në betejat asketike. Ajo bënte të gjitha punët e krahut në manastir dhe i kalonte netët me lot e me lutje të zjarra, që Zoti ta falte mëkatën e saj dhe ta rivendoste përsëri në hirin e pastërtisë. Mënyra e saj e jetesës i ndihmonte vëllezërit tej mase, por edhe e egërsoi djallin, kur pa prenë e tij t'i shpëtonte nga duart. Ky armik i egër i së mirës nuk mund ta pranonte këtë, prandaj ndërseu disa murgj xhelozë që të shpifnin për Theodhorin, duke e përgojuar për një grua nga një fshat aty pranë. Madje ata i sollën edhe një fëmijë, se ishte gjoja pjella e tij nga lidhja e paligjshme që kishte. Theodhori qëndroi i heshtur përpara akuzuesve të tij. Ajo nuk e zbuloi identitetin e saj të vërtetë dhe e pranoi sa kishte ndodhur si një ndëshkim i ardhur nga Perëndia. U përjashtua nga manastiri për shtatë vjet dhe e mori fëmijën me vete sikur të ishte i saj. Jetoi në një kasolle të vogël aty afër, në varfëri të thellë, duronte vapën e verës dhe të ftohtin e dimrit së bashku me tundimet e shumëfishta të djallit, derisa plotësoi vitet e përjashtimit nga manastiri dhe u bashkua me vëllazërinë sërish.

Kur u kthye në manastir, Theodhora i shtoi agripnitë, kreshmët dhe lutjet, duke treguar një bindje dhe durim akoma edhe më të madh se më parë. Ajo e mori fëmijën me vete, duke i mësuar atij të fitonte virtytet e shenjta ungjillore dhe lutjen e pandërprerë, kështu që ai u bë biri i saj shpirtëror i vërtetë sipas frymës. Fjeti në paqe pasi i dha porositë e fundit. Atë çast, avai i manastirit pa në një vizion një grua të veshur në rroba të shndritshme, të ngritur në ajër në korin e të drejtëve dhe të shenjtorëve. Atëherë e kuptuan se si qëndronte e vërteta dhe se sa shumë të gabuar kishin qenë, duke lavdëruar Perëndinë, i Cili kishte kryer një mrekulli aq të madhe. Ajo u pastrua nga pasioni trupor nëpërmjet betejës së fortë që kreu në manastir, madje duke ua kaluar edhe murgjve më të sprovuar në lutje dhe asketizëm, në papasionshmëri dhe pastërti engjëlllore.

* * * * *

– Oshënar Efrosin Kuzhinieri –

Vinte nga një familje e thjeshtë fshatare. U tërhoq në një manastir, ku ndihmonte në kuzhinë dhe kryente punët më të përlulura. Shumë vëllezër filluan ta tallnin, por ai duronte me butësi çdo përbuzje. Në manastir ishte një prift, mik i Perëndisë, i cili dëshironte me zjarr që Zoti t'i zbulonte se cilat ishin të mirat që Ai ruan për ata që e duan. Një natë, teksa flinte, në ëndërr iu duk sikur u ngjiti lart në Parajsë, në një kopsht të mrekullueshëm. Në mes të kopshtit ndodhej Efrosini, i cili shijonte nga të mirat e tij bashkë me engjëjt. Prifti iu afrua dhe e pyeti se ku gjendeshin, dhe Efrosini iu përgjigj: “Kjo është banesa e të zgjedhurve të Perëndisë që ti dëshiron të shohësh prej kohësh. Unë jam këtu nga mirësia e Perëndisë, i Cili deshi të më falte

mëkatet”. Pasi pa të mirat që gjendeshin atje, prifti e pyeti Efrosinin nëse mund të merrte disa nga frutat e kopshtit. Atëherë shenjti mori tri mollë dhe i vuri në xhepin e palltos së priftit. Në atë çast ai u zgjua nga kambana e manastirit, e cila binte për shërbesën e mëngjesit. Pasi u kthjellua nga gjumi dhe ëndrra, befas gjeti në pallton e tij tri mollët, të cilat lëshonin një aromë të mrekullueshme e të panjohur ndonjëherë më parë.

Kur shkoi në kishë, dalloi Efrosinin i cili po qëndronte në vendin e tij si zakonisht dhe pasi iu afrua, iu lut t’i tregonte se ku ishte natën që kaloi. Ai iu përgjigj: “Më fal atë, por isha këtu ku ti po më gjen tani”. Por prifti shpresëtar këmbënguli që të mos i fshihte bamirësitë e Perëndisë. Atëherë Efrosini i tha: “Po atë, isha në atë kopsht ku ti pe të mirat që Perëndia ruan për të zgjedhurit e Tij. Kështu Perëndia të zbuloi këtë mister”. Atëherë prifti dëshmoi te të gjithë për këtë zbulim dhe tregoi mollët si shenjë. Falë kësaj shenje, murgjit u ndihmuan shumë në rrugën e vështirë të virtytit dhe ata që hëngrën prej këtyre mollëve u shëruan nga çdo lloj sëmundjeje. Sa për Efrosinin e lumur, i cili u ruhej lavdërimeve të njerëzve, iku dhe u fsheh nga manastiri.

SHËN THEODHORA
NË ALEKSANDRI



SHĒN
EFROSIN

KUZHINIERI



— facebook.com/koash1991